

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL
PËR VITIN 2006

Kuvendi i Shqipërisë,

- njeh dhe vlerëson rolin e Komisionit të Shërbimit Civil, që ligji “Statusi i nëpunësit civil” i jep për mbikëqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil;
- thekson se ky institucion i pavarur është organi administrativ që cakton ligji për të zgjidhur ankesat në lidhje me nëpunësit civilë;
- këmbëngul në domosdoshmërinë e vendosjes dhe forcimit të marrëdhënieve ndërinstitucionale ndërmjet Komisionit të Shërbimit Civil dhe institucioneve të tjera të përcaktuara në ligj;
- nxit dhe mbështet kryerjen e reformave në administratën publike, në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Konstaton:

- mosmbajtjen parasysh në veprimtarinë vjetore të Komisionit të Shërbimit Civil të rezolutës së Kuvendit të 16 shkurtit 2006 dhe të detyrimeve që ky institucion duhej të përmbushte vitin e kaluar në ushtrimin e funksionit të tij ligjor;
- tejkalimin përsëri të kompetencave të veta ligjore nga Komisioni i Shërbimit Civil, çka tregon se ky institucion ende s’e ka të qartë funksionin e tij në raport me institucionet e tjera;
- shfaqje të mungesës së objektivitetit dhe rritje në mënyrë artificiale të numrit të ankesave të nëpunësve civilë ndaj administratës publike edhe në rastet e ristrukturimeve të institucioneve qendrore;
- kundërvënie ndaj rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit për marrjen e masave disiplinore ndaj nëpunësve civilë të larguar për shkelje të ligjit;
- njëanshmëri politike dhe subjektivitet në formulimin e raportit vjetor për veprimtarinë e këtij institucioni.

Kërkon për vitin 2007:

- zbatimin rigoroz të detyrave të përcaktuara për Komisionin e Shërbimit Civil në ligjin “Statusi i nëpunësit civil”;
- vendosjen e një platforme të qartë për mbështetjen e reformave dhe rritjen e performancës profesionale e të ndershmërisë në administratën publike, në funksion të arritjes së standardeve të domosdoshme për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian;
- hartimin e rekomandimeve dhe ndjekjen e tyre për përmbushjen e sugjerimeve të dhëna në nivel qendror e vendor;
- bashkëpunimin me Këshillin e Ministrave dhe me institucionet e tjera për kryerjen e reformave në administratë, në përputhje me statusin e nëpunësit civil;
- përmirësimin e rolit të Komisionit të Shërbimit Civil për mbikëqyrjen e menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën e pushtetit vendor.

19 mars 2007